



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ELBASAN**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE**

Elbasan më \_\_\_\_, \_\_\_\_, 2022

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**PROÇES-VERBAL PËR HARTIMIN E KRITEREVE**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: "Rikonstruksion i gjendjes faktike të rrugës "Marije Buda" dhe "Hamdi Roseni", me fond limit 17,651,150 (shtatëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë pa t.v.sh.**

- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 45210000-2 - Punime ndërtimi**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor, Bashkia Elbasan, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

**Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.**

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

**Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.**

**Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 të miratuara nga APP.**

## **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës ....

Kriteri (1- a) është vendosur në bazë të nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kriteri (1-b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:**

Sipas Shtojcës 7.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

**2.2.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim që ka paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2022 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Gjithashtu një deklaratë nga administratori i shoqërisë mbi kontratat publike dhe private me të cilat është angazhuar shoqëria gjatë vitit 2022 sipas formatit të mëposhtem:

Nr	Emertimi i kontrates	Vendi i zbatimit te kontrares (Bashkia)
1		
2		

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifave vendore).

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

### 2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**-Për të vërtetuar përvojën e mëparshme duhet të paraqiten:**

**-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:** Formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 9) i shoqëruar me: -Kontratë punimesh; -Situacion përfundimtar; -Akt-kolaudimi; -Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:** Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: - Kontratë punimesh, -Situacionin përfundimtar, -Akt-kolaudimin, -Çertifikatën e marrjes në dorëzim, -Faturat tatimore për Situacionin përfundimtar.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Investitorit.

## **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

### **2.3.2 Liçensa profesionale e shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës:**

- **N.P -1 A** Punime gërmimi në tokë
- **N.P- 4 A** (Rrugë,autostrada,mbikalime,hekurudha,tramvaj,metro,pista aeroportuale)
- **N.P- 7 A** Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje.
- **N.P-11 A** (Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë).
- **N.S-6 A** Sinjalistika rrugore jondriçuese
- **N.S-18 A** Punime topogjeodezike

***Për Operatorët e huaj të bëhet njësimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit perkates , ne plotësimin te licensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontratës .***

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku jane te percaktuar kategorite perkatese dhe niveli i klasifikimit per licensat e subjekteve qe ushtrojn veprimtari ne fushen e ndertimit.

*Pikat e licensave jane percaktuar ne baze te zerave te pershkruara ne preventivin e projektit.*

*Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi.*

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
<i>NP-1</i>	<i>Punime gërmimi në tokë.</i>	<i>Punime gërmim dheu</i>	<i>A</i>	<i>0-20 milion</i>

NP-4	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale	<i>Punime per rikonstruksionin e rrugeve, punime trotuaresh, shtrim me pllaka etj.</i>	A	0-20 milion
NP-7	<i>Ujësjetllës, gazsjellës, vajsjetllës, vepra kullimi e vaditje</i>	<i>Punime për ndertimin e KUZ dhe KUB</i>	A	0-20 milion
NP-11	<i>Ndërtime për nënstatione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike</i>	<i>Punimet elektrike sipas preventivit, F.V Ndricues, FV shtylla metalike konike ndricimi etj</i>	A	0-20 milion
NS-6	<i>Sinjalistika rrugore jodriçuese</i>	<i>Punimet e sinjalistikes te parashikuara ne prevnetiv.</i>	A	0-20 milion
NS-18	<i>Punime topogjeodezike.</i>	<i>Punimet per rikonstruksionin e rruges si dhe punimet per kanalizimet paraqesin nevojen e punimeve topogjeodezike</i>	A	0-20 milion

**2.3.3** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administrator i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçensën dhe listpagesat e shoqërisë, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune
- b) Diplomë

*(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë).*

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit.** Dokumentacioni provues për drejtuesin teknik, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

**2.3.4** Nje punësim mesatar **per periudhen Shtator 2022 - Nentor 2022**, i të paktën **35** (tridhjetë e pesë) personave të vërtetuar me :

- a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhen e kërkuar.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesipermdo të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përlllogaritje të saktë të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Në këtë kontekst, autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përlllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit, orëve të punës (8 ore në ditë për çdo punonjës) afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së punës. Në numrin e përcaktuar për fuqinë punëtore janë përlllogaritur stafi teknik dhe inxhinierik si dhe stafi administrativ.

**2.3.5** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për periudhen **Shtator 2022 - Nentor 2022**, si mëposhtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)

Për punonjësit e mesiperm duhet të paraqitet kontrata e punës noteriale e vlefshme dhe diploma.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit. **Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori i shoqerise.**

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesiperm do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

*Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:*

<i>1 (nje) Inxhinier Ndërtimi</i>	<i>Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit të punimeve (Punime Germimi dhe Prishje, punimet për rikonstruksionin e rruges etj)</i>
<i>1 (nje) Inxhinier Hidroteknik</i>	<i>Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të KUZ dhe KUB</i>
<i>1 (nje) Inxhinier Elektrik</i>	<i>Punimet elektrike sipas preventivit</i>
<i>1 (nje) Inxhinier Gjeodet</i>	<i>Eshtë përgjegjës për piketimet, zbatimin e saktë të kuotave të projektit në ndërtimin e linjes së KUZ dhe KUB</i>

### 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të kualifikuar, si mëposhtë:

- 2 (dy) Punonjës teknik ndërtimi
  - 1 (një) Punonjës teknik topograf
  - 1 (një) Hidraulik
  - 2 (dy) Elektriçistë
  - 2 (dy) Hekurthyes
  - 2 (dy) Murator
  - 2 (dy) Karpentier
  - 2 (dy) Shofere
  - 1 (një) Manovrator
  - 1 (një) Automakinist
- Për punonjësit e mesiperm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën **Shtator 2022 - Nentor 2022**.
  - Për punonjësit e kualifikuar të ndërtimit të paraqitet Çertifikatat/diplomat/deshmia të leshuara nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.SH” i ndryshuar.



- Për tekniket e ndërtimit dhe teknikun topograf do të pranohet vetem diploma e shkollës së mesme/licence profesionale nga institucionet përkatëse.
- ***Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.***
- Ndersa per punonjesit shofere dhe manovratorë të mjeteve të rënda duhet të paraqiten dëshmi te aftesise profesionale / leje drejtimi dhe certifikate e aftesimit profesional sipas rastit, të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore.
- **Në rast se operatori ekonomik, i disponon mjetet e rënda në pronësi, duhet ti ketë operoret e mjeteve në listëpagesë per periudhen Shtator 2022 - Nentor 2022.**
- **Për mjetet e rënda të cilat janë të marra me qera, OE duhet të paraqesë për manovratorin/makinistin, kontratën e punës së vlefshme, dëshminë e drejtimit të vlefshme, lëshuar nga institucionet përkatëse, dëshmitë e drejtimit të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore, por pa qenë e nevojshme që këta manovratorë të figurojnë në listëpagesën e OE per periudhen e kerkuar.**

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues qe OE i disponon punonjesit e mesiperm do të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjesit e kualifikuar lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kane përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **Punonjesi teknik ndërtimi** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndertimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjes teknik topograf**-është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimevet ë ndertimit, sipas zërave të preventivit (për zbatimin e saktë të kuotave të projektit, punimet per KUB).
- **Elektricitist** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve
- **Hidrauliku** është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Karpentierët** janë të nevojshëm për prerjen dhe montimin e strukturave prej druri e metali si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri, bashkimin dhe montimin e elementëve metalik apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet.
- **Hekurkthyesi** është i nevojshem për përzgjedhjen, prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit, për realizimin zërave të preventivit të punimeve.
- **Muratori** është i nevojshëm për realizimin e punimeve te shtresave te betonit, borduarave etj sipas zërave të preventivit.

- **Shofer** është i nevojshëm për drejtimin e mjeteve si kamione, kamionçina etj.
- **Manovratori është i nevojshëm** për përdorimin e mjeteve të renda si eskavator, fadrome etj. si dhe azuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të renda për punime ndërtime dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.
- **Automakinisti është i nevojshëm** përdorimin e mjeteve si kamion me vinç.

### 2.3.7 Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, (I ndryshuar).
- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Përgjegjës për dëmet në mjedis” gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, (I ndryshuar)

Për punonjësin e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën **Shtator 2022 - Nentor 2022**.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesipërmdo të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Këto kriteret janë vendosur në mbështetje të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM Nr.312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit gjykon se për mbarëvajtjen e punimeve, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e ekspertit për ndihmën e parë dhe ndërhyrjet ndaj emergjencave, ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në kantierin e punimeve.

Në mbështetje të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM Nr.312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”

Përsa i përket punonjesit përgjegjës për dëmet në mjedis sqarojmë se kriteri është vendosur në përputhje të plotë me klauzolat e Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” me qëllim marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese për mbrojtjen e mjedisit.

Autoriteti kontraktor duke vlerësuar të gjitha detyrat që mbulojnë këta punonjes për sigurinë në kantier, mbrojtjen e mjedisit, ka gjykuar të jenë staf mbështetës pasi duhet të kryejë funksione të tilla të rëndësishme në kantier si mirëmbajtjen e kontrollin para fillimit të punës dhe kontrollin periodik

të impianteve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve; caktojnë kufijtë dhe përgatitin zonën e stoqeve dhe të depozitimit të materialeve, në veçanti kur bëhet fjalë për lëndë dhe substanca të rrezikshme; përshtatin në funksion të zhvillimit të kantierit, të kohëzgjatjes efektive që duhet t'i jepet llojeve të ndryshme të punës ose fazave të punës; kryejnë bashkëpunimin midis punëdhënësve dhe punëmarrësve të pavarur; kryejnë bashkëveprimin me aktivitetet që ndodhin në vendndodhje, brenda dhe në afërsi të kantierit.

**2.3.8** Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo te rrezikshme” ose te kete kontrate sherbimi noteriale per objektin konkret me shoqeri te licensuara. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, date 11.05.2009 “Per disa ndyshime ne legjislacionin ne fuqi per licensat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise”) Licenca duhet të shoqerohet me akt miratimin.

**Argumentimi:** Kriteri per licencen e leshuar nga QKL me kodin III. 2. B eshte vendosur qe AK te kete sigurine qe operatori ekonomik qe do te ofertoje te jete i pajisur me certifikatat e mesiperme ose te kete kontrate sherbimi me subjekte te licencuara me licencen e lartepemundur, te lidhura me objektin e prokurimit, gje e cila krijon bindjen dhe sigurine te Autoriteti Kontraktor qe ky Operator Ekonomik i zoteron kapacitetet teknike per realizimin me sukses te kontrates.

Në seksionin “Kategoria III.2. “Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.B”, pika 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar parashikohet se:“ Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. 9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.”

Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, ku të përfshihen ndër të tjera edhe transporti i mbetjeve të ngrurta, gjatë kryerjes së veprimtarisë ose te kene kete kontrate sherbimi noteriale per objektin konkret me shoqeri te licensuara si me siper.

Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se “Ushtimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.” Sa më sipër konstatohet se gjatë kryerjes së punimeve, referuar edhe parashikimeve të preventivit, shfaqet ndër të tjera kryerja e veprimtarisë transporti i mbejteve inerte i cili referuar kuadrit ligjor në fuqi duhet te kryhet nga subjekte te licensuara dhe është në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.Kerkesa per te paraqitur akt miratimin eshte bere per te verifikuar nese mbetjet qe do te largohen jane te percaktuara ne licencen e subjektit per tu administruar dhe transportuar.

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet te paraqesë :

Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:

- SSH/EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilesisë*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent

- SSH/EN-ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i këtij bashkimi duhet të dorëzojë çertifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

**Argumentimi:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashton kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

**2.3.10** Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr.	Lloji i imjetit	Njesi	Sasi	Status i
1	Kamion me kapacitet mbajtes mbi 18 ton	Cope	1	Ne pronesi ose me qira

2	Kamion me kapacitet mbajtes 7-10	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
3	Kamioncine me kapacitet mbajtes 2 deri ne 5 ton	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
4	Eskavator me goma	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
5	Kamion me vinc	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
6	Vibrator betoni	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
7	Freze asfalti	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
8	Autobot uji	Cope	1	Ne pronesi ose meqira
9	Autobetoniere	Cope	1	Ne pronesiosemeqira
10	Autopompebetoni	Cope	1	Nepronesiosemeqira
11	Rrul me kapacitet mbi 10 t	Cope	1	Nepronesiosemeqira
12	Gjenerator	Cope	1	Nepronesiosemeqira
13	Matrapik	Cope	1	Ne pronesi ose me qira

a) Për mjetet që regjistrohen ne regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikaten e pronesise, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë (vetem mjetet e transportit) dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumentet e mesiperme duhet te shoqerohen me kontraten noteriale perkatese te qerese, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Per mjetet e transportit me qera te paraqitet gjithashtu Çertifikatë për transport mallrash për te trete dhe me qira. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

b) Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërme, do të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zerave te punimeve.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomik **mjetet dhe paisjet teknike** Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe paisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Percaktimi i makinerive është bërë referuar zërave të punimeve reflektuar në tabelë sa më poshtë:

Nr	Lloji i Makinerive	Proceset sipas preventivit	Sasia
1	Eskavator me me goma	Germim dhe me eskavator goma 0.25m <sup>3</sup> në trasenë e rrugës gjeresi >2 m kat III me shk në mjet ( 502 m x 3.5m x 0.3 m)~ 2387 m <sup>2</sup> x 0.3 m sipas preventivit	copë 1
2	Kamion me ving	Për vendosjen në veper të tubave të betonit, shtyllave të ndriçimit etj	copë 1
3	Kamiona me kapacitet mbajtes mbi 18 Ton	Transport dhue, materiale ndertimi rere zhavorr etj.	copë 1
4	Kamion me kapacitet mbajtes 7 - 10 ton	Tranport pllaka betoni , materiale të ndryshme që do të vendosen në veper, tuba betoni etj.	copë 2
5	Kamionçine me kapacitet mbajtes 2 deri në 5 ton	Për transportin e materialeve në kantier, pajisjeve të punës etj	copë 1
6	Freze asfalti	Për frezim/skarifikimin e shtresave asfaltike sipas preventivit	
7	Matrapik	Për punimet e prishjes sipas preventivit	copë 2
8	Autopompe betoni	Për hedhjen e betonit gjatë punimeve sipas preventivit	cope 1
9	Vibrator betoni	Vibrim betoni sipas proceseve dhe markave të ndryshme pjese e preventivit	copë 2
10	Autobot uji	Për procese të ndryshme gjatë punës, lagjen e kantierit sipas preventivit dhe specifikimeve teknike	cope 1
11	Rrul me kapacitet mbi 10 t	Cilindrim i trasese së sheshit të pallateve sipas preventivit	copë 1
12	Gjenerator	Furnizimin me energji të pajisjeve të ndryshme gjatë proceseve të punës	cope 1

13	Autobetoniere	Prodhim betoni sipas proceseve dhe markave te ndryshme pjese e preventivit	copë 1
----	---------------	--	--------

**2.3.11** Operoret ekonomike duhet te kene ne pronesi/kontrate qeraje/kontrate furnizimi 1 (nje) fabrike te prodhimit te elementeve te betonit - bordurave dhe pllakave, e cila duhet te jete e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, per te cilen duhet te paraqesin dokumentcionin e pronesise/kontraten e qerases/kontraten e furnizimit shoqeruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërme, do të dorëzohet nga operatori **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d dhe pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zerave te punimeve.

**2.3.12** Operoret ekonomike duhet te kenene pronesi/kontrate qeraje/kontrate furnizimi 1 (nje) fabrike inertesh, e cila duhet te jete e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, per te cilen duhet te paraqesin dokumentcionin e pronesise/kontraten e qerases/kontraten e furnizimit shoqeruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërme, do të dorëzohet nga operatori **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d dhe pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zerave te punimeve.

#### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet Teknike per proceduren respektive jane hartuar nga drejtoria e projekteve, pjese perberese e struktures se Bashkise Elbasan, qe ka hartuar edhe projektin perkates te zbatimit duke gene elemente perberes te tij. Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se

planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat perkatese të Ligjit nr. 9290 , date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kërkesat e ligjit të Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".

Specifikimet Teknike janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

**Fondi Limit i përlogaritur për këto procedure është hartuar në bazë të VKM nr 629 date 15.07.2015 'Per Miratimin e Manualeve Teknike të Cmimeve të Ndërtimit dhe analizat teknike të tyre',**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*